

V E N D I M
Nr. 324, datë 4.7.2002

**PËR PAGESËN E KONTRIBUTEVE TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTAREB TË
MIGRACIONIT (IOM)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", ndryshuar me ligjin nr.8903, datë 23.5.2002, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pagesën, nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, të kontributeve të prapambetura, në shumën prej 9 000 000 (nëntë milionë) lekësh, që i ka vendi ynë Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM), sipas Marrëveshjes të datës 2 tetor 1992, ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe kësaj organizate.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

3. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Punëve të Jashme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pande